

## Hermon Bonati

### Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Performancës

Hermon Bonati ka lindur në Tiranë, më 18 dhjetor 1969.

Në vitin 1995, përfundon studimet e larta në degën Inxhinieri Ndërtimi, Ndërtime Civile dhe Industriale, pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ai ka kryer trajnime dhe specializime të ndryshme që kanë lidhje me fushën e ndërtimit, administrimit publik, vlerësimit të pasurive të paluajtshme, prokurimin publik, etj.

Në periudhën 1995-1997 ka punuar si inxhinier ndërtimi, specialist në Degën e Investimeve pranë Drejtorisë së Financës, në Ministrinë e Pushtetit Lokal (Sekretariati Shetëror për Pushtetin Lokal) duke kontribuar në evidentimin e nevojave për investime në njësitë e vetëqeverisjes vendore në rang vendi, hartimin e projektbuxheteve për investime në këto njësi si edhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratave të financuara.

Në vitin 1997 deri në vitin 1998, ka ushtruar detyrën e kryetarit të degës së investimeve pranë Drejtorisë së Financës në Ministrinë e Brendëshme (në strukturën për pushtetin vendor) duke organizuar dhe garantuar mbarëvajtjen e punës në evidentimin e nevojave për investime në njësitë e vetëqeverisjes vendore, hartimin e projektbuxheteve dhe mbikëqyrjen e realizimit të kontratave.

Në periudhën 1998-2000 ka punuar si specialist, e më pas përgjegjës, në Sektorin e Emergjencave dhe Mbrojtjes nga Zjarri, në Ministrinë e Pushtetit Lokal duke kontribuar në administrimin dhe garantimin e mbarëvajtjes dhe ligjshmërisë në procesin e vlerësimit të emergjencave civile si dhe evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga forcat madhore.

Në periudhën 2000-2004, jep kontributin e tij, si inxhinier i vetëm i strukturës së Drejtorisë së Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Pushtetit Lokal, për mbikëqyrjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, zbulimin e parregullsive në zbatueshmërinë e legjislacionit për prokurimin publik dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra e shërbime, për mbi 440 njësi të qeverisjes vendore dhe 12 prefektura, Prej vitit 2004 deri në vitin 2017, ka punuar si specialist dhe përgjegjës në Sektorin e Licencimit në Ndërtim në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (më pas Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e më pas Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit) duke dhënë kontributin e tij në administrimin dhe garantimin e mbarëvajtjes dhe ligjshmërisë në procesin e trajtimit dhe dhënies së lejeve për ushtrimin e profesioneve në fushën e zbatimit në ndërtim, studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudimit në ndërtim si edhe vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Në këtë periudhë ka qënë pjesë edhe e Sekretarisë teknike të komisioneve të posaçme për licencimin profesional të shoqërive të ndërtimit dhe individëve në fushën e zbatimit, projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, si dhe ka dhënë

kontribut të spikatur në hartimin e të gjitha akteve regullatore në këtë fushë, të cilat janë në fuqi edhe aktualisht.

Në periudhën 2017-2018, në pozicionin e specialistit në Sektorin e Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve të Zhvillimit Turistik, pranë Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ka marrë pjesë në hartimin e strategjive, planeve dhe studimeve mbi fizibilitetin e projekteve në fushën e zhvillimit dhe promovimit të turizmit si edhe në hartimin e akteve ligjore për statutet speciale në fushën e turizmit.

Nga viti 2018 deri në 2019, ka punuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në rolin e përgjegjës të Sektorit të Koordinimit, pranë Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit, duke organizuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë e asistimit dhe monitorimit të autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit me fonde publike, kryesisht për përmbushjen e kushteve të dispozitave në fuqi për prokurimin publik, në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, si edhe duke hartuar rekomandime të dedikuara apo përgjithësuese për autoritetet kontraktore si edhe hartuar materiale specifike informuese.

Përpos pozicioneve të mësipërme, ai ka përmbushur edhe rolin e anëtarit të Komisionit të posacëm për dhënien e licencave profesionale për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në fushën e zbatimit në ndërtim për periudhën 2008-2019.

Prej vitit 2019 mban pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Performancës, pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Ai është njohës i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.